

KONTRATE SHITBLERJEJE

Ne Tirane sot me daten 04.11.2011 perpilohet kjo kontrate shitblerjeje te kuotave te kapitalit te shoqerise "S-SARANDA" Sh.P.K. midis paleve si me poshte:

1. **Shitesi:** Vasilios Jatrou i biri i Dhimitrit i datelindjes 15.01.1947 lindur ne Sarande dhe banues ne New York, i identifikuar me Nr. Pasaporte: 112744727 , madhor me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e ortakut privat qe zoteron 70% te aksioneve te shoqerise "SARANDA" Sh.P.K
2. **Bleresi:** Thoma Jani i biri i Janit i datelindjes 16.01.1953 lindur ne Cerrik, Elbasan dhe banues ne Cerrik lagjia Nr.2, i identifikuar me Nr. Pasaporte BR2069751 madhor me zotesi te plote per vepruar.

Shitesi eshte ortakut privat qe zoteron 70% te aksioneve te shoqerise "S-SARANDA" Sh.P.K me Nr. NIPT : K 54208810 J e regjistruar me date 19.08.2005 ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne Cuke, Sarande.

Pjesen tjeter prej 30% te aksioneve e zoteron shteti perfaqesuar nga "Ministrine e Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes"

Shitesi Vasilios Jatrou eshte pronar i ligjshem i 70% te pjeseve te kapitalit te kesaj shoqerie dhe pranon qe 51% te aksioneve t'ia shese bleresit Thoma Jani kundrejt shumes 60.064.230 (gjashtedhjetë milion e gjashtedhjetë e kater mije e dyqind e tridhjetë) Leke.

Bleresi Thoma Jani pranon t'i bleje 51% te aksioneve te shitesit Vasilios Jatrou me cmimin e mesiperm, shume e cila i eshte dhene shitesit perpara lidhjes se kesaj kontrate

Shitesi Vasilios Jatrou pranon se e ka marre nga bleresi te gjithe shumen e mesiperme.

Ne zbatim te nenit 9 te Statutit te shoqerise shitesi Vasil Jatrou ka njoftuar per te ushtruar te drejten e parablerjes ortakut tjeter te shoqerise "Ministrine e Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes" e cila me shkresen Nr. 7839/1 Prot. date 4.11.2010 eshte pergjigjur se konfirmon se nuk eshte e interesuar te bleje keto kuota, shkrese e cila i bashkengjitet kesaj kontrate.

Baza ligjore e kesaj kontrate eshte neni 73 pika 1 germa b dhe pika 2 e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe statuti i shoqerise.

Per sa me siper lidhet kjo kontrate shitblerjeje per te vertetuar kalimin e pronesise se kuotave te kapitalit te shoqerise "SARANDA" Sh.P.K nga shitesi tek bleresi.

Bashkengjitur kesaj kontrate eshte dhe njoftimi i ortakut Vasilios Jatrou drejtuar ortakut tjeter "Ministrine e Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes".

Kjo kontrate pasi iu lexua paleve nenshkrhet prej tyre me vullnetin e lire.

SHITESI

VASILIOS JATROU



BLERESI

THOMA JANI



NJOFTIM

KERKUESI: Vasilios Jatru i biri i Dhimitrit , ortak i shoqerise "S.Saranda" sh.p.k..

OBJEKTI : Njoftim per transferimin e pjeseve te kapitalit , sipas N.9 te Statutit te Shoqerise "S.Saranda"sh.p.k.

MINISTRISE SE EKONOMISE TREGETISE DHE ENERGJITIKES

TIRANE

Z.Minister,

Shoqeria e perbashket "S.Saranda" sh.p.k. eshte krijuar me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane me Nr.7073 date 11.10.1994 me pjese marrje te ortakeve mua kerkuesin me 70% te kuotave dhe shtetin shqiptar perfaqesaur nga Ministria e Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes me 30% te kuotave me qender te veprimtarise ne Cuke te qytetit te Sarandes.

Une ortaku Vasilios Jatru deshiroj dhe kam vendosur qe te **shese 51% te pjeseve** te kapitalit nga 70% qe une disponoj aktualisht ne kete shoqeri personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri.

Sipas N. 9 te Statutit te shoqerise thuhet se " Pjeset e kapitalit Themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit Themeltar.

Plani i transferimit te pjeseve te kapitalit i Njoftohet shoqerise dhe gjithe ortakeve."

Per kete arsye ju informoj nepermjet ketij njoftimi se cmimi i shitjes do te jete me **1000 leke per cdo pjese** te shitur

Pjeset qe une deshiroj te transferoj tek personat e trete perfshin 51% te pjeseve qe une disponoj.

Per sa me siper mbetem ne pritje te pergjigjes Tuaj neqoftese jeni dakort dhe miratoni transferimin e pjeseve te mia tek peronat e trete, per vazhdimin e procedurave te metejshme

Sarande me 31.10.2011

ME RESPEKT
ORTAKU VASILIOS JATRU

